




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
GJYKATA KUSHTETUESE

Buletini periodik i Gjykatës Kushtetuese


Vendimet mars-prill 2024



Buletini periodik i vendimmarrjes

Nr. 2 , mars-prill 2024

© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë



Ky botim u mundësua me mbështetje nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Shënim: Opinonet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë botim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane apo të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



HYRJJE

Në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm me publikun dhe median, të garantimit të transparencës, si dhe të rritjes së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, si një nga parimet më të rëndësishme dhe thelbësore të administrimit të drejtësisë, Gjykata publikon Buletinin Periodik të vendimmarrjes së saj. Ai ka si qëllim informimin dhe njohjen e praktikantëve të së drejtës, studiuesve të ligjit, e çdo lexuesi, me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe me qëndrimet e mbajtura prej saj. Kështu, botimi i sjell vendimet në mënyrë të përmbledhur dhe me një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për lexuesin. Për secilën prej tyre, paraqiten faktet që lidhen me çështjen konkrete, vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet e kërkuarit, ashtu edhe vendimmarrja e mënyra e votimit.

Në këtë numër të dytë do të gjeni të gjitha vendimet përfundimtare si dhe disa vendime të përzgjedhura të Mbledhjes së Gjyqtarëve, të dhëna gjatë periudhës mars-prill 2024.

PËRMBAJTJA

Kontroll i akteve normative	4
Gjykim incidental	6
Ankim kushtetues individual (vendime përfundimtare)	8
Vendime të Mbledhjes së Gjyqtarëve për ankimin kushtetues individual	30

Identiteti kombëtar dhe trashëgimia kulturore – Parimi i shtetit të së drejtës – Parimi i hierarkisë së akteve ligjore

FJALË KYÇE

Marrëveshje për administrim/ administrim indirekt/ ligj miratues/ fondacion/ Konventa e Parisit/ rol parësor/ zona të trashëgimisë kulturore/ peizazh kulturor/ Parku i Butrintit

Parashikimet e Marrëveshjes së Administrimit, sipas modelit të administrimit indirekt, garantojnë rolin parësor të shtetit, pasi nuk parashikojnë dhe nuk lejojnë zhveshjen e shtetit nga pronësia. Të drejtat dhe kompetencat që i janë dhënë Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në asnjë rast nuk tejkalojnë ato të një administrimi të zakonshëm të pasurisë dhe nuk përmbajnë elemente sovrane që i përkasin shtetit.

Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit (Marrëveshja për Administrimin e Parkut të Butrintit) – vendimi nr. 34, datë 24.04.2024

Faktet

Ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe AADF-së është lidhur Marrëveshja për Themelimin e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit dhe në vijim, mes këtij të fundit dhe Ministrisë së Kulturës është lidhur Marrëveshja e Administrimit, me anë të së cilës fondacionit i është dhënë e drejta ekskluzive dhe detyrimi për administrimin indirekt të pasurisë kulturore, Parkut Kombëtar të Butrintit. Bazuar në ligjin nr. 27/2018, marrëveshja u miratua nga Kuvendi me ligjin nr. 50/2022.

Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me pretendimin se aktet objekt kërkesë cenojnë disa parime kushtetuese.

Vlerësimi i Gjykatës

Juridiksioni i Gjykatës- Ligji nr. 50/2022, ashtu si edhe çdo ligj tjetër, nuk përjashtohet nga kontrolli kushtetues në kuptim të përmbajtjes së nenit 131, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës. Për sa i përket Marrëveshjes së Administrimit që i bashkëlidhet ligjit nr. 50/2022, edhe pse tipikisht nuk jemi para një akti me karakter të përgjithshëm, ajo ka marrë, për këtë shkak, veshje formale me ligj. Gjykata ka juridiksion edhe bazuar në natyrën kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në kërkesë, si një nga elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues.

Cenimi i identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kulturore i lidhur me parimin e shtetit të së drejtës dhe hierarkisë së akteve ligjore - Në zbatim të Kushtetutës dhe Konventës së Parisit, ligji nr. 27/2018 ka parashikuar disa modele të administrimit të pasurive kulturore në pronësi publike, që mund të jenë direkte dhe indirekte, si dhe ka lejuar kryerjen e administrimit nga persona juridikë jofitimprurës. Por ndërsa pasuria i kalon në administrim personit juridik jofitimprurës, titulli i pronësisë në çdo rast i mbetet shtetit. Ky model rezulton të jetë i lejueshëm nga neni 3 i Kushtetutës dhe nga Konventa e Parisit. Roli i shtetit për mbrojtjen dhe garantimin e pasurive kombëtare dhe atyre universale nuk ushtrohet përmes administrimit të tyre vetëm nga institucione/organe shtetërore, por edhe përmes gjetjes së formave dhe modeleve të administrimit që garantojnë ruajtjen e konservimin dhe ndalojnë degradimin ose dëmtimin e këtyre pasurive. Parashikimet e Marrëveshjes së Administrimit garantojnë ushtrimin e rolit parësor të shtetit dhe mbështesin qëndrimin se veprimtaria e fondacionit dhe kompetencat e tij lidhen me funksionin e administrimit të pasurisë kulturore, pa tejkaluar dhe pa ndryshuar këto kompetenca, për sa kohë që fondacioni nuk përjashtohet nga përmbushja e çdo detyrimi ligjor që ka sipas legjisllacionit çdo entitet tjetër, qoftë ai shtetëror ose publik. Në këndvështrim të nenit 17 të Konventës së Parisit, fondacioni ushtron edhe rolin për mbledhjen e donacioneve, me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (katër gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

Parimi i sigurisë juridike - E drejta e pronës private - Parimi i proporcionalitetit

FJALË KYÇE

Kthim prone/ kompensim prone/ vendim i GJEDNJ-së/ vlerësim financiar/ zë kadastral/ prag minimal/ res judicata

Ndryshimet e bëra nga ligjvënësi me ligjin nr. 77/2022 janë në përputhje me qëndrimin e GJEDNJ-së në çështjen Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë dhe vendimin nr. 4/2021 të Gjykatës. Në çdo rast të vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare, ato garantojnë pragun minimal prej 10% të vlerës së pronës, të llogaritur sipas zërit kadastral aktual të saj.

Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi” (ndryshimet në Ligjin e Pronave) - vendimi nr. 89, datë 30.04.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Faktet

Në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së të vitit 2020 në çështjen Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë dhe vendimit të Gjykatës nr. 4, datë 15.02.2021, ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 77/2022 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin e Pronave nr. 133/2015. Në zbatim të këtij ligji Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 313/2023.

Kërkuesja ka kundërshtuar në Gjykatë këto akte, duke pretenduar se parashikimet e tyre cenojnë parimin e sigurisë juridike, të drejtën e pronës private dhe parimin e proporcionalitetit.

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Parimi i sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e pronës private dhe parimin e proporcionalitetit – Në lidhje me pretendimet për dispozitat e ligjit nr. 77/2022, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të përcaktojë të drejtat kushtetuese të cenuara, si rrjedhojë e dhënies Këshillit të Ministrave të kompetencave të përcaktuara në nenin 3 të ligjit. Për sa i takon nenin 4, pretendimet janë haptazi të pabazuara. Për më tepër, parashikimet e kësaj dispozite përbëjnë garanci shtesë për ruajtjen e fondit të tokës të vënë në dispozicion të ATP-së për qëllime të kompensimit fizik të subjekteve të shpronësuara. Parashikimet e nenit 6, pika 2, kanë të bëjnë me çështje të zbatimit të ligjit nga ana e organeve të përfshira në këtë proces. Për më tepër, nëse nga zbatimi i kësaj procedure, rast pas rasti, subjektet përfituese kanë pretendime në lidhje me cenimin e të drejtave të tyre, ato mund t'i drejtohen gjyqësorit të zakonshëm. Për sa i takon nenin 9, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 77/2022, pretendimet nuk janë të argumentuara në këndvështrimin kushtetues.

Në lidhje me VKM-në nr. 313/2023, pretendimet se cenohet e drejta për procese brenda një kohe të arsyeshme dhe të drejtën për mjete juridike efektive, nuk janë argumentuar në aspektin kushtetues. Pretendimet se VKM-ja nuk lejon të drejtën e ankimit nuk gjejnë mbështetje në aspektin kushtetues, pasi kjo e drejtë garantohet si nga neni 42 i Kushtetutës, ashtu dhe nga legjislacioni në fuqi e mund të kufizohet vetëm sipas kritereve të përcaktuara nga neni 17 i Kushtetutës.

Për sa u përket pretendimeve për nenin 1, pika 1 dhe 2, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 77/2022 dhe VKM-së nr. 313/2023, ato përbëjnë *res judicata*, pasi në lidhje me to Gjykata ka mbajtur qëndrim në vendimin nr. 5, datë 13.02.2024. Ndryshimet e bëra nga ligjvënësi me ligjin nr. 77/2022 janë në përputhje me qëndrimin e GJEDNJ-së në çështjen Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë dhe vendimin nr. 4/2021 të Gjykatës. Në çdo rast të vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare, ato garantojnë pragun minimal prej 10% të vlerës së pronës, të llogaritur sipas zërit kadastral aktual të saj.

Vendimarrja

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, me shumicë votash, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare (një gjyqtar u shpreh me mendim kundër).

Prezumimi i pafajësisë - E drejta për ankim efektiv

FJALË KYÇE

***Pezullim dënimi me burg/
shërbim prove/ afati i provës/
kushtet dhe detyrimet gjatë
periudhës së provës/ vendimi i
dënimit i ankimuar***



***Në kuptim të parimit të
prezumimit të pafajësisë
personi i dënuar me vendim
të gjykatës së shkallës së
parë konsiderohet i
pafajshëm përderisa fajësia
e tij nuk është provuar me
vendim gjyqësor të formës së
prerë.***

***Vendimi penal i gjykatës së
shkallës së parë që ka
pezulluar ekzekutimin e
dënimit, nuk mund të vihet
në ekzekutim në rastin kur i
dënuari ka paraqitur ankim,
nëse për atë nuk garantohet
parimi i prezumimit të
pafajësisë dhe e drejta e
ankimit efektiv substancial.***

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (shfuqizimi i nenit 59, pika 4, fjalia e dytë, të Kodit Penal) – vendimi nr. 20, datë 03.04.2024

Faktet

Prokuroria Dibër ka paraqitur në gjykatë kërkesë për revokimin e pezullimit të vendimit të dënimit me burgim të dhënë ndaj shtetasit D.D., pasi ky i fundit, sipas referimit të bërë nga Shërbimi i Provës, nuk kishte pëmbushur kushtet dhe detyrimet gjatë kohës së provës. Vendimi i dënimit me burgim (i pezulluar) ishte ankimuar nga shtetasi D.D. në gjykatën e apelit. Gjykata referuese ka vlerësuar se neni 59, pika 4, fjalia e dytë e KP-së dhe nenet 22, pika 1, shkronja “b” dhe 37 të ligjit nr. 79/2022 bien në kundërshtim me nenin 30 të Kushtetutës dhe nenin 6, pika 2, të KEDNJ-së, për rrjedhojë ka pezulluar gjykimin e çështjes dhe ka vënë në lëvizje gjykimin incidental të normës.

Vlerësimi i Gjykatës

Vendimi për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të personit të gjetur fajtor është kompetencë e gjykatës, duke mos përjashtuar këtu as gjykatën e shkallës së parë. Parashikimi për ekzekutimin gati menjëherë të një vendimi të tillë të gjykatës së shkallës së parë duket se nuk mban në konsideratë se ai është i ankimueshëm dhe potencialisht i cënueshëm nga gjykata më e lartë. Ekzekutimi gati menjëherë i vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, e vendos personin në kushtet e përbushjes së këtij dënimi alternativ me burgim, pikërisht të atyre kufizimeve në liritë dhe të drejtat që lindin nga vënia e tij në provë, pavarësisht faktit se në kuptimin kushtetues vijon të konsiderohet ende i pafajshëm, për sa kohë ai vendim nuk ka marrë formë të prerë. Ndërsa vendimi i dënimit me burgim i gjykatës së shkallës së parë, ekzekutimi i të cilit nuk është pezulluar, nuk e ngarkon personin e dënuar me përbushjen e detyrimeve përkatëse ndaj shtetit, për sa kohë, ai vendim nuk ka marrë formë të prerë.

Përmbajtja e nenit 59, pika 4, fjalia e dytë, të KP-së vë në dyshim edhe parimin e sigurisë juridike, pasi krijon paqartësi dhe dykuptimshmëri në drejtim të pasojave të vendimit gjyqësor të ekzekutueshëm.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar fjalinë e dytë të pikës 4 të nenit 59 të Kodit Penal (tre gjyqtarë u shprehën me mendim pjesërisht kundër).

Kriteret e legjitimitit për vënien në lëvizje të gjykimit incidental nga gjykatat e zakonshme

FJALË KYÇE
Ekzekutimi i vendimit penal të huaj/ ekstradim/ parashkrimi i dënimit/ parimi i reciprocitetit/ Konventa për Ekstradimin/ Protokollit i katërt shtesë/ mungesë harmonizimi/ rezervë ligjore në normën ndërkombëtare



Gjykata e Lartë e ka ngritur çështjen kushtetuese pa identifikuar qartë se cili është ligji i zbatueshëm. Pretendimet dhe çështjet që kërkojnë zgjidhje synojnë orientimin e Gjykatës së Lartë për mënyrën se si të veprojë ajo në një situatë të caktuar. Këto pretendime ngjajnë me kërkimin e formulimit të opinioneve këshillimore për mënyrën se si duhet të veprojë gjykata referuese, çka nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

Gjykata e Lartë (kontrolli i kushtetutshmërisë së shkronjës “ë” të nenit 491 të KPP-së) - vendimi nr. 46, datë 12.03.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Faktet

Mbi bazën e kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Italisë për ekstradimin nga Republika e Shqipërisë në atë të Italisë të shtetasit shqiptar B.B. alias B.I., prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur në gjykatë kërkesë për miratimin e lejimit të ekstradimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka miratuar lejimin e ekstradimit, vendim që është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur mospranimin e kërkesës për ekstradim, pasi i ka vlerësuar të bazuar pretendimet e për parashkrimin e ekzekutimit të dënimit sipas ligjit shqiptar. Gjykata e Lartë, e vënë në lëvizje me rekurs të prokurorit, ka pezulluar gjykimin e çështjes dhe i është drejtuar Gjykatës për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të shkronjës “ë” të nenit 491 të KPP-së.

Vlerësimi i Gjykatës

Legjitimiti i gjykatës referuese - Çështja kushtetuese është bazuar mbi premisa teorike në lidhje me (mos)zbatueshmërinë e normave ligjore me fuqi të ndryshme juridike, ndërkohë që Gjykata e Lartë nuk duket të ketë vënë në dyshim zbatueshmërinë e nenit 10, paragrafi 2, të KEE-së sipas Protokollit të Katërt Shtesë për shkak të qenies së saj e vetëzbatueshme. Për sa kohë që një analizë e tillë shteruese mungon në vendimin e Gjykatës së Lartë, i takon kësaj të fundit që në ushtrim të kompetencës kushtetuese të përcaktojë nëse në rastin konkret dispozitat e KEE-së nuk janë të vetëzbatueshme dhe, më tej, duke arritur në përfundimin se dispozita e vetme e zbatueshme është shkronja “ë” e nenit 491 të KPP-së, të përcaktojë se nuk ka asnjë interpretim të saj që është i pajtueshëm me parimet kushtetuese. Vetëm pasi gjykata referuese të ketë arritur në përfundimin që ka vetëm një dispozitë të zbatueshme, e cila mund të interpretohet vetëm në atë kuptim që vë në dyshim kushtetutshmërinë e saj, duke e vënë në pamundësi ta zbatojë për zgjidhjen e çështjes konkrete, ajo mund të vërë në lëvizje kontrollin incidental të normës ligjore.

Vendimarrja

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, njëzëri, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Mosdënimi pa ligj

FJALË KYÇE

I mitur në kohën e kryerjes së veprës penale/ përgjysmim dënimi/ dënim pa ligj/ korrigjim gabimi material/ rishikim vendimi/ modifikim thelbësor i vendimit

Edhe pse procedurat gjyqësore të procesit të themelit që kanë deklaruar fajtor dhe kanë dënuar kërkuesin duken arbitrare pasi bëhet fjalë për lejimin e gabimeve të dukshme nga pikëpamja e ligjit që çojnë në "mohim të drejtësisë", nuk vihet në dyshim vendimi i Gjykatës së Lartë në drejtim të mënyrës se si ajo ka interpretuar nenin 114 të KPP-së.

Gjykata e Lartë, duke pasur parasysh se vendimi i saj e zhvishte kërkuesin nga e drejta për të korrigjuar vendimin penal nëpërmjet mjetit të zgjedhur nga ai, ka identifikuar ekzistencën e një mundësie tjetër për rishikimin e vendimit penal të dënimit.

Viktor Ymeraj (mjetet juridike për korrigjimin e mosaplikimit nga gjykatat të nenit 51 të Kodit Penal) - vendimi nr. 13, datë 07.03.2024

Faktet

Kërkuesi në vitin 2001 është dënuar me 25 vjet burgim nga gjykata e shkallës së parë (vendimi i themelit) për disa vepra penale. Gjatë atij procesi kërkuesi ka qenë në mungesë dhe nuk është evidentuar fakti se ishte i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale. Rrjedhimisht, në caktimin e dënimit nuk u aplikua neni 51 i KP-së. Vendim i dënimit mori formë të prerë pasi nuk u ankimua. Pas vënies në ekzekutim të tij, kërkuesi u angazhua në tre procese gjyqësore të veçanta për përgjysmimin e masës së dënimit, konkretisht për: (i) shuarjen e dënimit; ii) rishikimin e vendimit; iii) korrigjimin e gabimit material në vendimin e formës së prerë, në bazë të nenit 114 të KPP-së.

Procesi kushtetues u vu në lëvizje nga kërkuesi për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës për korrigjimin e gabimit material. Në atë proces gjykata e shkallës së parë e rrëzoi kërkesën me arsyetimin se mosaplikimi i nenit 51 të KP-së në vendimin e themelit nuk është gabim material, kurse gjykata e apelit ndryshoi vendimin duke aplikuar nenin 51 të KP-së, me arsyetimin se aplikimi i tij është detyrim dhe jo e drejtë e gjykatave. Kolegji Penal prishi vendimin e gjykatës së apelit dhe la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se paligjshmërisë së dënimit nuk mund t'i jepet zgjidhje nëpërmjet procedurës së ndreqjes së gabimit material, por vetëm nëpërmjet goditjes së vendimit përmes ankimit ose kërkesës për rishikim.

Pas këtij vendimi, kërkuesi i është drejtuar gjykatës së zakonshme sërish me kërkesë për rishikim, proces që në kohën e shqyrtimit të ankimit kushtetues ishte në vijim.

Vlerësimi i Gjykatës

Parimi i mosdënimit pa ligj - Gjykata konstatoi se gjatë procesit gjyqësor të themelit, të vitit 2001, i zhvilluar në mungesë të kërkuesit, as avokati, as prokurori nuk kanë evidentuar faktin e të qenit të tij të mitur në kohën e kryerjes së veprës penale dhe as vetë gjykata nuk ka verifikuar moshën e kërkuesit në atë kohë, lidhur me aplikimin e nenit 51 të KP-së. Në procesin gjyqësor për korrigjimin e gabimit material kërkuesit iu njoh e drejta, me vendim të formës së prerë të gjykatës së apelit, që në vendimin penal të dënimit të aplikohet ulja e dënimit sipas nenit 51 të KP-së. Për rrjedhojë ai hoqi dorë nga çdo mjet tjetër ankimi që kishte përdorur deri në atë kohë.

Edhe pse gabimi i gjykatave të zakonshme në zbatimin e ligjit penal në procesin e themelit u konsiderua i asaj natyre që vë në diskutim pajtueshmërinë e vendimit të dënimit të kërkuesit me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, Gjykata vlerësoi se nuk i takon asaj të ripërcaktojë faktet e çështjes ose mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme. Referuar edhe rekomandimit të Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor (i katërt) përmes të cilit ka kërkuar rishikimin e vendimit të themelit, në të cilin gjykatat e zakonshme dhe prokuroria duhet të tregojnë kujdesin e duhur për të mundësuar riparimin e shkeljes të të drejtave kushtetuese të kërkuesit, pikërisht në lidhje me respektimin e parimit të mosdënimit pa ligj.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

E drejta e pronës private - E drejta e aksesit në gjykatë - Standardi i arsytimit të vendimit

FJALË KYÇE

Shpërblim dëmi/ fillimi i afatit të kërimit të shpërblimit të dëmit/ akt absolutisht i pavlefshëm/ kundërligjshmëria dhe faji si kushte për kërkimin e shpërblimit të dëmit.

Ndonëse gjykatat e faktit kishin arsyetuar se elementet e kundërligjshmërisë dhe të fajit të veprimeve të organeve u vërtetuan ditën që vendimi gjyqësor mori formë të prerë dhe, për pasojë, afati ligjor 3-vjeçar fillonte në atë ditë, Gjykata e Lartë nuk ka dhënë shpjegim se përse arsytimi i gjykatave të faktit ishte i pabazuar.

Besnik Canaj (afati i fillimit të parashkrimit të padisë për shpërblim dëmi jashtëkontraktor - neni 120 i Kodit Civil) – vendimi nr. 14, datë 07.03.2024

Faktet

Kërkuesi iu drejtua gjykatës për kundërshtimin e akteve të INUK që kishin vendosur prishjen e një objekti, si i ndërtuar pa leje, si dhe dënimin e tij me gjobë. Vendimi për prishjen e objektit u ekzekutua. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi shfuqizimin e akteve të INUK si absolutisht të pavlefshme. Vendimi u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e rekursit të INUK. Kërkuesi iu drejtua gjykatës për detyrimin solidar të subjekteve të interesuara për shpërblimin e dëmit të ardhur si pasojë e akteve të tyre të paligjshme. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendosi pranimin e pjesëshëm të padisë, duke reduktuar masën e shpërblimit të kërkuar, vendim që u la në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e padisë, me arsytimin se kërkuesit i është parashkruar e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit, pasi nga momenti që është bërë prishja e objektit e deri në momentin e paraqitjes së padisë për kërkim dëmi kishin kaluar më shumë se tre vjet.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e pronësisë e lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor - Qëndrimi i Gjykatës së Lartë është një qëndrim formalist dhe nuk ka analizuar në mënyrë kumulative katër kushtet e ekzistencës së përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor. Në momentin e prishjes së objektit nuk kanë qenë të qarta për kërkuesin dy kushte: kundërligjshmëria dhe faji i kryerjes së veprimeve të organit publik. Për kundërligjshmërinë dhe fajin, kërkuesi dhe subjektet e interesuara nuk ishin në dijeni, derisa u vendos me vendim përfundimtar, ku u përcaktua se akti administrativ për prishjen e objektit ishte i paligjshëm dhe, si i tillë, i kryer me faj nga organi publik. Ndonëse gjykatat e faktit kishin arsyetuar se elementet e kundërligjshmërisë dhe të fajit të veprimeve të organeve u vërtetuan ditën që vendimi gjyqësor mori formë të prerë, për pasojë afati ligjor 3-vjeçar fillonte në atë ditë, Gjykata e Lartë nuk është ndalur në këtë drejtim dhe nuk ka dhënë shpjegim se përse arsytimi i gjykatave të faktit ishte i pabazuar. Gjykata e Lartë e ka bërë joefektive të drejtën e aksesit të kërkuesit për të kërkuar dëmshpërblim, si mjeti i përdorur kundër arbitraritetit të ndërhyrjes së organeve shtetërore në pronën private.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

ANKIM KUSHTETUES INDIVIDUAL

Ecja e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual - Standardi i arsytimit të vendimit – Parimi i mosdiskriminimit - E drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme

FJALË KYÇE

Marrëdhënie pune/ zgjidhje e kontratës së punës/ diskriminim për shkak të bindjeve politike/ diskriminim për arsye fetare/ barra e provës/ ndihmë juridike falas/ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi. Gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese.

Elisabeta Cara (diskriminim në marrëdhëniet e punës)- vendimi nr. 16, datë 12.03.2024

Faktet

Kërkuesja ka qenë në marrëdhënie pune pranë Postës Shqiptare deri kur ndaj saj u mor masa disiplinore e largimit nga detyra. Duke pretenduar se kontrata e punës është zgjidhur në kundërshtim me ligjin, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi për dhënien e dëmshpërblimeve respektive, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës. Padia e saj u rrëzua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, vendim që u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, kurse Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkueses.

Vlerësimi i Gjykatës

Shterimi i mjeteve juridike efektive -Diskriminimi për arsye fetare nuk është parashtruar as në procesin administrativ, as në proceset gjyqësore ndaj kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Diskriminimi për arsye politike ishte deklaruar gjatë procesit administrativ dhe është përmendur gjatë procesit gjyqësor. Kërkuesja ka kundërshtuar zgjidhjen e kontratës për shkaqe të pajustificuara, bazuar edhe në shkaqet diskriminuese për shkak të bindjeve politike.

Legjitimitimi racione temporis -Kërkuesja kishte paraqitur një kërkesë për ndihmë juridike dytësore falas kur ishte brenda afatit 4-mujor, për shkak të situatës së saj ekonomike, me qëllim përgatitjen e ankimit kushtetues individual dhe kjo kërkesë ishte pranuar nga gjykata e zakonshme. Duke mos llogaritur kohën gjatë së cilës gjykata ka shqyrtuar dhe miratuar kërkesën për ndihmë juridike falas, ankimi kushtetues individual konsiderohet i paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

Standardi i arsytimit të vendimit i lidhur me parimin e mosdiskriminimit dhe të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme - Ndër shkaqet për diskriminim të padrejtë në marrëdhëniet e punës përfshihen edhe “bindjet politike” dhe “gjendja shoqërore” (referuar neneve 18 dhe 49 të Kushtetutës). Gjykatat e faktit, ndonëse kanë pasqyruar në vendim pretendimin për diskriminim për arsye politike dhe prapësimet e punëdhënësit, në arsyetim janë mjaftuar me konkluzionin e paraqitur nga punëdhënësi se kërkuesja ka vepruar me faj të rëndë, duke mos zbatuar detyrimet e saj kontraktore.

Gjykatat duhej të analizonin në mënyrë të shprehur nëse faktet e paraqitura nga kërkuesja shërbenin në mënyrë të mjaftueshme që barra e provës për diskriminim të kalonte te punëdhënësi, dhe, eventualisht, ky i fundit, të vërtetonte se nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis gjendjes shoqërore dhe bindjeve politike të kërkueses dhe trajtimit të pafavorshëm të pretenduar prej saj. Ndërkohë, edhe Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur një qëndrim të shprehur, pavarësisht se shkak i pretenduar ka natyrë kushtetuese.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (katër gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

E drejta e aksesit - Liria personale

FJALË KYÇE
Arrest në shtëpi/ tejkalim
afati i masës së sigurimit/
shuarje mase sigurimi

Gjykata e Lartë, ndonëse në vendimin e saj ka konstatuar se kërkuesja ka ngritur pretendime që kanë të bëjnë me interpretimin e gabuar të ligjit procedural penal nga gjykatat e posaçme për shuarjen e masës së sigurimit personal, për shkak të kalimit të afateve ligjore, nuk u ka dhënë përgjigje atyre, duke i lënë të pazgjidhura pasojat që kishin të bënin me të drejtën themelore kushtetuese siç është kufizimi i lirisë.

Mimoza Margjeka (*kufizimi i lirisë për shkak të masës së sigurimit personal*)

- vendimi nr. 17, datë 13.03.2024

Faktet

Kërkuesja u procedua për veprën penale të korrupsionit pasiv dhe GJKKO-ja e shkallës së parë vendosi ndaj saj masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, që u la në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Gjatë kohës që çështja ishte në gjykim kërkuesja ka kërkuar shuarjen e masës për shkak të tejkalimit të afatit, kërkesë që është rrëzuar nga GJKKO-të e shkallës së parë dhe të apelit me arsyetimin se afati i masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” është më i gjatë se në masa e sigurimit “Arresti në burg”. Kërkuesja paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë. Gjatë kohës që rekursi ishte në pritje për shqyrtim, GJKKO-ja e shkallës së parë e deklaroi kërkuesen fajtoresh sipas akuzës, duke vendosur edhe shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”. Ky vendim u la në fuqi nga GJKKO e Apelit.

Në lidhje me rekursin për vendimin e shuarjes së masës, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin me arsyetimin se çështja ka mbetur pa objekt, pasi masa e sigurimit nuk është në fuqi dhe kërkuesja është dënuar me vendim të formës së prerë.

Kërkuesja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna në procesin e shqyrtimit të kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit personal, me pretendimin e cenimit të lirisë personale.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e aksesit e lidhur me kufizimin e lirisë personale - Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs për të kundërshtuar interpretimin që gjykatat më të ulëta u kanë bërë dispozitave të KPP-së lidhur me kohëzgjatjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” për efekt të shuarjes së saj, duke parashtruar pasoja me natyrë kushtetuese. Gjykata e Lartë, ndonëse ka zgjidhur formalisht çështjen duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk ka bërë vlerësim në substancë të shkaqeve të tij, pra nëse gjykatat më të ulëta për shkak të interpretimit të ligjit procedural penal i kanë cenuar ose jo lirinë personale kërkueses për periudhën që ajo pretendonte se ka qëndruar përtej afatit të parashikuar nga ligji. Qasja e Gjykatës së Lartë në rastin konkret nuk është në koherencë as me qëndrimin e shprehur prej saj në vendimin njëses për praktikën gjyqësore në këtë aspekt. Gjykata e Lartë, duke mos kontrolluar ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit, ndonëse është ndodhur para pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit prej tyre, ka cenuar të drejtën e kërkueses për proces të rregullt ligjor.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

**E drejta e pronës private
- Parimi i
proporcionalitetit të
ndërhyrjes**

FJALË KYÇE

**Leje minerare/ masë
sigurimi pasuror/
sekuestro preventive/
sekuestro konservative/
disponim i lirë/ pasoja të
rënda**

**Vendimet që kanë pranuar
kërkesën e prokurorit për
caktimin e masës së sekuestros
preventive kanë vendosur jo
vetëm kufizimin e disponimit
të lirë, pra të shitjes së sasisë
së kromit dhe makinerive/
pajisjeve të minierës, por edhe
të përdorimit dhe posedimit të
këtyre të fundit, çka
nënkupton se kërkueses i është
kufizuar e drejta e pronës në të
gjitha tagrat e saj, pasi ajo nuk
mund të vijojë aktivitetin e saj
prodhues dhe tregtar, pra të
gjithë veprimtarinë
ekonomike.
Për të vlerësuar nëse ky
kufizim respekton kriteret
kushtetuese dhe konventore të
ndërhyrjes, Gjykata vlerëson
nëse ajo është bërë me ligj, për
interes publik dhe nëse
respekton kriterin e
proporcionalitetit.**

**Shoqëria “Kosturr Kromi” sh.p.k. (kufizimi i së
drejtës së pronës me vendime për vendosjen e
sekuestros preventive) - vendimi nr. 18, datë
19.03.2024**

Faktet

Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori ka vlerësuar se ekzistojnë dyshime të arsyeshme se administratori i kërkueses ka kryer veprën penale “Mashtrimi” dhe se shoqëria ka kryer veprime juridike që përbëjnë përgjegjësi penale sipas ligjit për përgjegjësinë penale të subjekteve juridike.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e kërkesës së prokurorit, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit sekuestro preventive dhe konservative ndaj asetëve të kërkueses, vendim që u konfirmua nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë. Në vijim, mbi kërkesën e kërkueses, gjykata e shkallës së parë vendosi revokimin pjesërisht të masës, vendim i cili u konfirmua nga gjykata e apelit. Në përfundim të hetimeve, mbi kërkesën e prokurorit, gjykata e shkallës së parë vendosi dërgimin në gjyq të çështjes penale dhe rrëzimin e kërkesës së kërkueses për revokimin e masës së sekuestros.

Kërkuesja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimeve që kanë vendosur masën e sekuestros mbi pasurinë.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e pronës – Vendimi i kundërshtuar është nxjerrë bazuar në nenin 274 të KPP-së, i cili lejon që gjatë një procedimi penal të caktohet sekuestro preventive, ndaj ndërhyrja në të drejtën e pronës është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik. Për sa i përket kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, merren në analizë disa elemente që lidhen drejtpërdrejt me natyrën e pasojave që prodhon vendimi për vendosjen e masës së sekuestros, konkretisht nevoja, përshtatshmëria dhe ashpërsia e masës. Për shkak të natyrës të veprës penale “Mashtrimi”, masa e sekuestros është e nevojshme, pasi është e aftë të sigurojë ndalimin e shitjes së kromit dhe transferimin e përfitimeve të persona të tretë, deri në përfundimin e procesit penal. Edhe pse masa e sekuestros kufizon të drejtën e pronës, ajo është e përshtatshme dhe jo përtej asaj që është e pashmangshme në këndvështrim të qëllimit të procedimit penal, për rrjedhojë konsiderohet se është e arsyeshme.

Lidhur me ashpërsinë e masës, ajo analizohet në raport me të tre tagrat e së drejtës së pronës: posedimin, gëzimin (ku përfshihet edhe gëzimi i fryteve të pronës ose zhvillimi i saj) dhe disponimin, ndaj, në çdo rast, këto lloj vendimesh duhet të përcaktojnë se cilin tagër të së drejtës së pronësisë do të prekin. Për sa i takon ashpërsinë e masës, në përfundim të diskutimeve, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës pasi nuk u arrit shumica e votave për vendimmarrje (tre gjyqtarë u shprehën me mendim paralel në drejtim të natyrës jopërfundimtare të këtyre lloj vendimesh).

**Liria personale –
E drejta për t`u zgjedhur
në raport me parimin e
proporcionalitetit –
Standardi i arsyetimit të
vendimit gjyqësor**

FJALË KYÇE
**Kandidat për kryetar
bashkie/ zgjedhje
vendore/ korrupsion
aktiv në zgjedhje/ e
drejta për t`u zgjedhur/
ushtrimi i mandati/
arrestim në flagrancë/
arresti në burg**

**E drejta për t`u zgjedhur
shtrihet jo vetëm mbi të
drejtën për të kandiduar,
por edhe mbi atë për të
ushtruar funksionin
publik, në rastin konkret
mandatin e kryetarit të
bashkisë, që lidhet me
bërjen e betimit në
mbledhjen më të parë të
këshillit bashkiak.**

**Kufizimi i lirisë personale
të kërkuesit është bërë për
një qëllim të ligjshëm dhe
ai nuk duket që të jetë
joproporcional në raport
me këtë qëllim. Për
rrjedhojë, edhe ndërhyrja
në të drejtën për t`u
zgjedhur nuk duket të jetë
joproporcionale në raport
me situatën që e ka bërë
të nevojshme në rastin
konkret.**

**Dhionisios Alfred Beleri (kufizimi i lirisë për shkak të
masës së sigurimit personal ndaj personit të shpallur
fitues në zgjedhjet vendore) - vendimi nr. 19, datë
21.03.2024**

Faktet

Kërkuesi ka kandiduar për kryetar të Bashkisë Himarë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023. Dy ditë para ditës së zgjedhjeve kërkuesi u arrestua në flagrancë si i dyshuar për korrupsion aktiv në zgjedhje dhe ndaj tij u caktua masa e sigurimit personal “Arresti në burg”, e vleftësuar e ligjshme nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Nga ana tjetër kjo gjykatë deklaroi moskompetencën lëndore dhe çështja iu kalua për kompetencë GJKKO-së së Shkallës së Parë, e cila e konfirmoi masën. Vendimi u la në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Pas zhvillimit të zgjedhjeve vendore, KZAZ-ja shpalli kërkuesin fitues dhe në vijim KQZ-ja vendosi t`i japë atij mandatin e kryetarit të Bashkisë Himarë. Pavarësisht kësaj, kërkuesi nuk e kreu betimin për shkak se ishte duke vuajtur masë kufizuese të lirisë “Arresti në burg”. Për këtë arsye kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Cenimi i barazisë përpara ligjit, e drejta për t`u zgjedhur dhe e mosdiskriminimit - Në lidhje me qëndrimin e ndryshëm të mbajtur për një çështje të ngjashme, gjykatat e zakonshme përcaktojnë mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe të zbatimit të ligjit, në funksion të çështjes konkrete, sipas specifikave dhe individualitetit të saj. Argumenti në vetvete, i paraqitur pa mbështetjen e një prove konkrete nuk përbën shkelje të parimit të barazisë përpara ligjit ose të mosdiskriminimit. Në lidhje me diskriminimin për shkaqe politike nuk provohet se procesi penal është i motivuar politikisht.

Cenimi i lirisë personale dhe i së drejtës për t`u zgjedhur në raport me parimin e proporcionalitetit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor - Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se ekziston dyshimi i arsyeshem i bazuar në prova se vepra penale është konsumuar nga kërkuesi. Ato kanë arsyetuar mjaftueshem përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e masës, duke konstatuar se kushtet e nenit 228, pika 3, të KPP-së plotësohen në mënyrë kumulative, përfshi rrezikun e largimit dhe se personat që kanë kryer veprën paraqesin rrezikshmëri të lart shoqërore. Për rrjedhojë, masa e sigurimit “Arresti në burg” nuk duket joproporcionale, në kontekstin e rrethanave të çështjes.

Vendosja e masës së sigurimit personal në ngarkim të kërkuesit ka pamundësuar kryerjen e procedurës së betimit si kryetar i zgjedhur i Bashkisë Himarë, për pasojë, kjo masë përbën një kufizim të së drejtës së kërkuesit për t`u zgjedhur. Sidoqoftë, duke qenë se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është bërë për një qëllim të ligjshëm dhe se kufizimi nuk duket të jetë joproporcional në raport me këtë qëllim, edhe ndërhyrja në të drejtën për t`u zgjedhur nuk duket të jetë joproporcionale në raport me situatën që e ka bërë të nevojshme atë në rastin konkret.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrezimin e kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

FJALË KYÇE
Korrigjim gabimi material/ ngarkesa e gjykatave të zakonshme/ interesa vetjakë dhe jetësorë/ përparësi në radhën e gjyqimit

Kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë argument se cenimi i së drejtës për të disponuar lirisht pasurinë i ka sjellë një pasojë të menjëhershme, jetike dhe ngushtësisht personale për t'i dhënë prioritet gjyqimit të çështjes së tij.

Arben Gjoleka (kohëzgjatja e paarsyeshme e procesit gjyqësor në gjykatën e apelit) – vendimi nr. 21, datë 04.04.2024

Faktet

Kërkuesi i është drejtuar gjykatës administrative për detyrimin e Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Tirana Veri të korrigjojë gabimin material në kontratën e shitblerjes së pasurisë dhe në pasqyrimin e të dhënave kadastrale, etj. Gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, vendim i cili është ankimuar nga të gjitha palët pjesëmarrëse në gjykim. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 04.05.2022. Pas një viti, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e tejzgjatjes së gjyqimit në gjykatën e apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës me argumentin se mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit.

Vlerësimi i Gjykatës

Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm – Në analizë të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete dhe kriterëve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese Gjykata vlerësoi se për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, çështja e kërkuetit është në pritje për shqyrtim në apel tashmë prej 1 viti e 11 muajsh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë është pothuajse 3 vjet. Kohëzgjatja e gjyqimit lidhet me ngarkesën e lartë në gjykatën e apelit dhe të gjyqtarit relator, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

Në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi*, çështja e tij nuk lidhet me interesa “vetjakë e jetësorë”, duke qenë se pretendimet kanë të bëjnë me pamundësinë e disponimit të së drejtës së pronës në masën faktike të saj. Koha prej 1 viti e 11 muajsh, për shqyrtimin e çështjes në raport me ngarkesën me të cilën përballet sistemi i drejtësisë nuk jep përparësi në radhën e shqyrtimi nisur edhe nga natyra e çështjes.

Kërkuesi, edhe pse ka barrën e provës, nuk ka paraqitur ndonjë argument se cenimi i së drejtës për të disponuar lirisht pasurinë i ka sjellë një pasojë të menjëhershme, jetike dhe ngushtësisht personale për t'i dhënë prioritet gjyqimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

Kriteret e legjitimitit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual - Legjitimimi *ratione materiae*

FJALË KYÇE

Dënim me gjobë i avokatit/ përjashtimi i avokatit/ konflikt interesi/ abuzim me të drejtat në procesin gjyqësor

Masa e gjobës nuk ka përcaktuar të drejta ose detyrime civile ndaj avokatit ose ka ndikuar në reputacionin e tij, rrjedhimisht vendimi që ka caktuar gjobën nuk hyn në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës.

Ahmet Jangulli (dënim me gjobë i përfaqësuesit ligjor) – vendimi nr. 22, datë 04.04.2024

Faktet

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka marrë në shqyrtim kërkesën e prokurorisë për pushimin e procedimit penal të regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetit A.B., ndaj disa punonjësve të bashkisë dhe ZRPP-së, Bulqizë. Në gjykim kallëzuesi është përfaqësuar nga kërkuesi, avokati Ahmet Jangulli. Prokuroria ka kërkuar përjashtimin e kërkuesit nga përfaqësimi për shkak të pranisë së konfliktit të interesit, pasi në kohën kur ai ka ushtruar detyrën e gjyqtarit ka gjykuar një çështje civile pronësie, ku kallëzuesi ka qenë palë e paditur.

Gjykata e ka përjashtuar kërkuesin nga përfaqësimi i kallëzuesit. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë në emër të kallëzuesit A.B., për përjashtimin e gjyqtarës që ka konstatuar konfliktin e interesit. Gjykata ka vendosur mospranimin e kërkesës, si e paraqitur nga personi që nuk i përket e drejta, si dhe dënimin e kërkuesit me gjobë në vlerën 10,000 lekë për abuzim me kërkesën. Kallëzuesi A.B., nëpërmjet kërkuesit, ka paraqitur ankim, i cili është rrëzuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me arsyetimin se vendimi i ndërmjetëm mund të ankimohet vetëm me vendimin përfundimtar. Kërkuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e tij.

Vlerësimi i Gjykatës

Legjitimimi ratione materiae - Pretendimet e kërkuesit lidhen, në thelb, me dënimin e tij me gjobë, në cilësinë e përfaqësuesit, disponim i cili është i lidhur ngushtësisht me disponimin parësor, atë të kërkesës për përjashtim të gjyqtarit. Caktimi i gjobës ndaj kërkuesit ka qenë një masë procedurale, e lidhur me ushtrimin e kompetencës së gjykatës për të siguruar zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor dhe konkretisht për të ndaluar abuzimin me ushtrimin e të drejtave gjatë procesit penal. Masa e gjobës nuk ka përcaktuar të drejta ose detyrime civile ndaj kërkuesit dhe nuk ka ndikuar në reputacionin e tij. Bazuar në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe argumenteve të paraqitura nga kërkuesi, natyrën e gjobës, qëllimin për të cilin ajo është vendosur dhe masën e saj, vlerësohet se ajo nuk prek ose ndërhyr në të drejtat kushtetuese të kërkuesit.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (një gjyqtar u shpreh me mendim kundër).

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj - Standardi i arsytimit të vendimit – E drejta për t'u dëgjuar - E drejta për t'u njoftuar

FJALË KYÇE
Masë disiplinore ndaj gjyqtarit/ vendimi i KLGJ-së/ juridiksion fillestar/ juridiksion rishikues/ ligji i kohës

Juridiksioni duhet të shihet në lidhje me momentin e vënies në lëvizje dhe zhvillimit të një procesi gjyqësor. Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për ushtrimin e juridiksionit rishikues për kontrollin e vendimmarrjes së gjykatës së apelit në kuptim të neneve 141 dhe 43 të Kushtetutës. Juridiksioni i saj në rastin konkret është ai rishikues, që është përcaktuar nga mjeti procedural i përdorur në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese.

Bujar Musta (juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e rekursit ndaj vendimit gjyqësor që ka shqyrtuar ankimin për masë disiplinore të gjyqtarit) – vendimi nr. 23, datë 04.04.2024

Faktet

Kërkuesi ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe për shkak të paraqitjes së disa ankesave nga palë në proces, ndaj tij nisi procedimi disiplinor. KLD-ja miratoi masën disiplinore të propozuar nga ministri i Drejtësisë “Vërejtje me paralajmërim”, të cilën kërkuesi e ankimoi në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e fundit ia kaloi çështjen për kompetencë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila vendosi rrëzimin e padisë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkuesit, vendosi mospranimin e tij.

Kërkuesi iu drejtua Gjykatës duke pretenduar, mes të tjerash, se kompetenca për të shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve të KLGJ-së i përket KPA-së dhe jo Gjykatës së Lartë.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit - Çështja e juridiksionit lidhet me momentin e vënies në lëvizje dhe zhvillimit të një procesi gjyqësor. Në rastin konkret ankimi i kërkuesit ndaj vendimit të KLD-së është shqyrtuar nga gjykata kompetente sipas ligjit të kohës. Po kështu edhe shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së apelit është bërë nga Gjykata e Lartë, juridiksioni kushtetues i së cilës në rastin konkret është ai rishikues. Edhe ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 nuk kanë prekur apo ndryshuar juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të dhëna nga gjykatat më të ulëta, në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e ligjit prej tyre. Ushtrimi i këtij juridiksioni rishikues nga një gjykatë tjetër, përfshi Gjykatën Kushtetuese apo KPA-në, do të binte ndesh me Kushtetutën.

Vetëm fakti që kërkuesi nuk ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë për pretendimin shtesë të paraqitur prej tij në lidhje me juridiksionin e saj, nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese. Për më tepër, duke e shqyrtuar e rekursin kundër vendimit të gjykatës së apelit, nënkupton se Gjykata e Lartë e ka vlerësuar edhe çështjen e juridiksionit.

E drejta për t'u dëgjuar e lidhur me të drejtën për t'u njoftuar – Në fazën e shqyrtimit paraprak Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje në bazë të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, i cili ka pasur mundësinë të parashtrijë të gjitha pretendimet e tij në lidhje me procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe, në vijim, edhe në lidhje me juridiksionin e Gjykatës së Lartë. Kërkuesi nuk provohet që të jetë vendosur në pozita të pafavorshme në krahasim me palën tjetër në proces. Pavarësisht se nuk është njoftuar edhe përmes adresës elektronike, kërkuesi nuk ka provuar se kjo parregullsi procedurale e ka vënë në pamundësi të ushtrijë të drejtat procedurale që i njihen në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

E drejta e aksesit substancial - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor - Parimi i paanshmërisë në gjykim

FJALË KYÇE

Ngritje në detyrë/ vlerësim etik dhe profesional i gjyqtarit/ shkelje e rëndë procedurale/ interpretim përfundimtar

Për sa kohë që pretendimi kryesor lidhet me kryerjen e shkeljeve të rënda procedurale që kanë ndikuar në vlerësimin e përgjithshëm të kërkueses, Gjykata e Lartë, si gjykatë e ligjit, duhej të jepte përkufizimin e “shkeljeve të rënda”, duke interpretuar në mënyrë përfundimtare dispozitat ligjore.

Klodiana Veizi (procesi i vlerësimit të kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë) – vendimi nr. 24, datë 09.04.2024

Faktet

Kërkuesja kandidoi në procedurat e hapura nga KLGJ-ja për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për disa pozicione të lira. Në përfundim të procedurave, KLGJ-ja miratoi raportin e vlerësimit etik dhe profesional të kërkueses, duke e vlerësuar atë në nivel të përgjithshëm “shumë mirë”. Kërkuesja u ankuu në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila e rrëzoi padinë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkueses, pasi shkaqet e ngritura në të nuk lidhen me shkelje të rënda procedurale.

Kërkuesja iu drejtua Gjykatës me pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në disa aspekte të saj, si dhe për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e aksesit substancial e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor – Pretendimi kryesor i kërkueses lidhet me kryerjen e “shkeljeve të rënda procedurale”, konkretisht mosrespektimin e parashikimeve ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë metodat, treguesit për vlerësimin sasior dhe cilësor të punës së gjyqtarit, të cilat nuk kanë gjetur zbatim gjatë vlerësimit të kryer nga KLGJ-ja. Gjykatat nuk kanë arsyetuar nëse këto shkelje të pretenduara nga kërkuesja janë të tilla që përfshihen në konceptin e “shkeljeve të rënda” me karakter procedural, që përbëjnë shkakun e vetëm për kundërshtimin e procesit të vlerësimit. Gjykata e Lartë, edhe pse në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë e ligjit, kishte detyrimin të jepte përkufizimin e “shkeljeve të rënda” me karakter procedural, duke interpretuar në mënyrë përfundimtare dispozitat ligjore, e lidhur kjo edhe me hapësirën e juridiksionit gjyqësor për kontrollin e veprimtarisë së KLGJ-së, nuk e ka arsyetuar vendimin në këtë drejtim. Kjo mungesë arsyetimi nuk i ka dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes së kërkueses, duke mos e bërë efektiv aksesin e saj në gjykatë.

Parimi i paanshmërisë në gjykim - në kushtet kur çështja do të rishqyrtohet nga Gjykata e Lartë, Gjykata nuk u ndal në analizën e këtij pretendimi.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

E drejta e aksesit substancial – Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor - Parimi i paanshmërisë në gjykim

FJALË KYÇE

Ngritje në detyrë/ vlerësim etik dhe profesional i gjyqtarit/ shkelje e rëndë procedurale/ interpretim përfundimtar

Për sa kohë që pretendimi kryesor lidhet me kryerjen e shkeljeve të rënda procedurale që kanë ndikuar në vlerësimin e përgjithshëm të kërkueses, Gjykata e Lartë, si gjykatë e ligjit, duhej të jepte përkufizimin e “shkeljeve të rënda”, duke interpretuar në mënyrë përfundimtare dispozitat ligjore.

Klodiana Veizi (procesi i vlerësimit të kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë) – vendimi nr. 25, datë 09.04.2024

Faktet

Kërkuesja kandidoi në procedurat e hapura nga KLGJ-ja për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për disa pozicione të lira. Në përfundim të procedurave, KLGJ-ja miratoi raportin e vlerësimit etik dhe profesional të kërkueses, duke e vlerësuar atë në nivel të përgjithshëm “shumë mirë”. Duke qenë se nuk ishte dakord me vlerësimin “shumë mirë” për aftësitë organizative, kërkuësja e ankimoi vendimin e KLGJ-së në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila e rrëzoi padinë dhe, në vijim, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkueses, pasi shkaqet e ngritura në të nuk lidhen me shkelje të rënda procedurale.

Kërkuesja iu drejtua Gjykatës me pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në disa aspekte të saj, si dhe për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e aksesit substancial e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor – Pretendimi kryesor i kërkueses lidhet me kryerjen e “shkeljeve të rënda procedurale”, konkretisht mosrespektimin e parashikimeve ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë metodat, treguesit për vlerësimin sasior dhe cilësor të punës së gjyqtarit, të cilat nuk kanë gjetur zbatim gjatë vlerësimit të kryer nga KLGJ-ja. Gjykatat nuk kanë arsyetuar nëse këto shkelje të pretenduara nga kërkuësja janë të tilla që përfshihen në konceptin “shkelje të rënda” me karakter procedural, që përbëjnë shkaku e vetëm për kundërshtimin e procesit të vlerësimit. Gjykata e Lartë, edhe pse në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë e ligjit, kishte detyrimin të jepte përkufizimin e “shkeljeve të rënda” me karakter procedural, duke interpretuar në mënyrë përfundimtare dispozitat ligjore, e lidhur kjo edhe me hapësirën e juridiksionit gjyqësor për kontrollin e veprimtarisë së KLGJ-së, nuk e ka arsyetuar vendimin në këtë drejtim. Kjo mungesë arsytimi nuk i ka dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes së kërkueses, duke mos e bërë efektiv aksesin e saj në gjykatë.

Parimi i paanshmërisë në gjykim - në kushtet kur çështja do të rishqyrtohet nga Gjykata e Lartë, Gjykata nuk u ndal në analizën e këtij pretendimi.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

E drejta për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj - E drejta e aksesit substancial

FJALË KYÇE
Pakujdesi e rëndë/ dëm pasuror dhe jopasuror/ i mitur/ zotësi për të vepruar/ përfaqësues ligjor/ lindje e së drejtës së padisë/ parashkrim i padisë/ pezullim i parashkrimit

Si gjykatat e faktit ashtu dhe Gjykata e Lartë kanë disponuar vetëm në lidhje me ushtrimin nga kërkuesit të së drejtës për të paraqitur padi, sipas afateve ligjore për paraqitjen e saj, që lidhet me parashkrimin e padisë në rastin e të miturve, çka përbën parakusht për shqyrtimin e themelit të pretendimeve.

Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar provat dhe as nuk ka bërë ripërcaktim të fakteve, por, në analizë të dispozitave të KC-së, ka kontrolluar mënyrën e zbatimit të tyre nga gjykatat më të ulëta në drejtim të çështjes së afatit të paraqitjes së padisë.

Lirena Demaj, Leonard Demaj (parashkrimi i padisë në rastin e të miturve) - vendimi nr. 26, datë 09.04.2024

Faktet

Babai i kërkuesve, punonjës në shoqërinë CEZ, gjatë riparimit të një defekti ka rënë në kontakt me rrymën elektrike, për pasojë ka ndërruar jetë. Për këtë ngjarje, dy fëmijët në moshë madhore dhe bashkëshortja e tij paditën shoqërinë për shpërblim dëmi real pasuror dhe jopasuror (padi që është pranuar). Kërkuesit nuk ishin palë në proces pasi në atë kohë ishin të mitur. Në vitin 2013, ata iu drejtuan gjykatës me padi për shpërblimin e dëmit moral dhe ekzistencial të shkaktuar nga vdekja e babait të tyre. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë vendosi rrëzimin e padisë, për shkak të parashkrimit. Gjykata e Apelit Vlorë vendosi prishjen e vendimit pasi duke qenë se në kohën kur ka ndodhur ngjarja kërkuesit kanë qenë të mitur, afati i parashkrimit ishte pezulluar deri në momentin që ata fituan zotësinë e plotë për të vepruar. Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Vlorë.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj në lidhje me të drejtën e aksesit substancial - Në thelb të vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme qëndron interpretimi i dispozitave të KC-së në lidhje me parashkrimin e padisë në rastin e të miturve, çështje për të cilën kanë disponuar si gjykatat e faktit ashtu edhe Gjykata e Lartë. Në prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë bërë vlerësim të provave dhe as të ketë ripërcaktuar faktet e çështjes, por, në analizë të dispozitave përkatëse të KC-së, ka kontrolluar mënyrën e zbatimit të tyre nga ana e gjykatave më të ulëta, duke bërë interpretimin përfundimtar si gjykatë ligji.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

FJALË KYÇE

Dëmtime fizike/ person me aftësi të kufizuara/ lidhje shkakësore/ interes vetjak/ përparësi

Disa çështje paraqesin interes të veçantë si, për shembull kompensimi për dëmtime të shëndetit, siç janë ato që lidhen me zhvendimin e dëmtimeve fizike, të cilat duhet të gjykohen me përparësi nga gjykatat.

Julian Çela (kohëzgjatja e paarsyeshme e procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë) - vendimi nr. 27, datë 11.04.2024

Faktet

Në vitin 2014 kërkuesi pësoi dëmtime të rënda fizike për shkak të një shpërthimi me eksploziv të ndodhur në mjediset e punëdhënësit. Për pasojë, ai iu nënshtroi ndërhyrjeve dhe trajtimeve spitalore dhe farmaceutike. Në vitin 2016, kërkuesi iu drejtua gjykatës me padi për detyrimin e punëdhënësit që t'i paguajë dëmin pasuror dhe jopasuror. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e rrëzoi padinë me arsyetimin se nuk provohet lidhja shkakësore mes veprimeve me faj të punëdhënësit dhe pasojës së ardhur, vendim që u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Mbi bazën e rekursit të kërkuesit çështja u regjistrua në Gjykatën e Lartë. Kërkuesi i drejtoi Gjykatës së Lartë kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të gjyqësorit, për të cilën ajo vendosi rrëzimin e kërkesës.

Vlerësimi i Gjykatës

Shqyrtimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm – Në analizë të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete dhe kriterëve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese Gjykata vlerësoi se për sa i përket rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi, ai e ka lidhur të drejtën e tij, në thelb, me zhvendimin e dëmit të shkaktuar nga dëmtimet fizike të pësuara gjatë ushtrimit të detyrës pranë palës së paditur (punëdhënësit). Edhe pse çështja e kërkuesit, për nga natyra e saj, nuk përfshihet në kategorinë e çështjeve që Gjykata e Lartë ka përcaktuar se duhet të shqyrtohen me përparësi, duke pasur parasysh jo vetëm statusin e kërkuesit si person me aftësi të kufizuara, por edhe interesin e tij të lartë vetjak për shkak të natyrës së kësaj çështjeje, si edhe referuar faktit se Gjykata e Lartë nuk ka ndërmarrë ende ndonjë veprim për caktimin e datës së shqyrtimit të rekursit, kjo çështje duhet të ketë përparësi në radhën e shqyrtimit të saj.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

**E drejta për t`u
grykuar nga një gjykatë
e caktuar me ligj –
Parimi i paanshmërisë
në gjykim – Standardi
i arsytimit të
vendimit gjyqësor**

FJALË KYÇE

**Jurist i spikatur/
procedurat e emërimit në
Gjykatën e Lartë/
procedurat e vlerësimit të
kandidatëve/ skualifikim i
kandidatit/ delegim i
gjyqtarit/ mendim
pjesërisht kundër/
mendim paralel**

**Për shkak të natyrës së
pretendimeve të
parashtruara në rekurs,
Gjykata e Lartë duhej të
kishte mbajtur qëndrim të
shprehur në lidhje me
interpretimin dhe zbatimin e
nenit 307 të KPC-së, në
mënyrë që t`i jepte përgjigje
të arsytuar pretendimit të
kërkueses për respektimin e
standardit të arsytimit të
vendimit gjyqësor.**

Kestrin Katro (interpretimi i nenit 307 të KPC-së) – vendimi nr. 28, datë 11.04.2024

Faktet

Kërkuesja ka aplikuar në procedurën e shpallur nga KLGJ-ja për emërimin në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur. Në përfundim të verifikimeve për kushtet dhe kriteret e kandidimit, pasi shqyrtoi raportin e ILDKPKI-së për kriterin e pasurisë, ashtu edhe pretendimet e kërkueses, KLGJ-ja vendosi skualifikimin e saj dhe përjashtimin nga kandidimi. Kërkuesja paraqiti padi në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila vendosi rrëzimin e padisë, vendim që u prish nga Gjykata e Lartë, duke rikthyer çështjen për rigjykim, me arsytimin se mungonte hetimi i plotë dhe i gjithanshëm, se nuk është lejuar kryerja e aktit të ekspertimit dhe se nuk i është dhënë përgjigje e argumentuar pretendimeve kryesore të kërkueses. Në rigjykim, gjykata e apelit, pasi administroi aktin e ekspertimit, rrëzoi pretendimet e kërkueses, me argumentin se nuk plotësohej kriteri i pasurisë, kurse Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit të saj.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta për t`u grykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj - Gjyqtari që ka marrë pjesë në trupin gjykues në gjykatën e apelit ishte caktuar me delegim nga KLGJ-ja në përputhje me kompetencat e saj dhe me parashikimet e nenit 45 të ligjit nr. 96/2016, pasi plotësonte kriteret ligjore. Trupi gjykues që ka shqyrtuar çështjen e kërkueses është formuar në mënyrë të rregullt.

Parimi i paanshmërisë në gjykim - Fakti që disa gjyqtarë që kanë shqyrtuar çështjen në gjykatën e apelit kanë qenë pjesë e procedurave për promovim të zhvilluara nga KLGJ-ja, nuk përbën rrethanë të mjaftueshme për të vënë në dyshim paanshmërinë e tyre. Marrëdhënia e KLGJ-së me ata gjyqtarë nuk është personale në kuptim të nenit 72 të KPC-së, por sistemike, për rrjedhojë nuk mund të përfshihet në ato shkaqe që kanë të bëjnë me pasjen e interesit për çështjen në gjykim apo që lidhen me arsye serioze njëanshmërie.

Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor - Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit që ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, përveç arsytimit përmban edhe mendimin pjesërisht kundër dhe arsytimin paralel të njërit gjyqtar, si dhe mendimin e pakicës të një gjyqtari tjetër. Për sa i përket pretendimit me natyrë kushtetuese për arsytimin e vendimit të gjykatës së apelit, të lidhur me mungesën e harmonisë dhe koherencës ndërmjet pjesës arsytuese dhe asaj urdhëruese, Gjykata e Lartë nuk e ka marrë në shqyrtim dhe nuk i ka dhënë përgjigje në pjesën arsytuese të vendimit, por është mjaftuar me pasqyrimin e tij vetëm në pjesën hyrëse të vendimit. Për rrjedhojë, mungesa e arsytimit në vendimin e Kolegjit Administrativ, në lidhje me mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të nenit 307 të KPC-së, vë në dyshim respektimin e standardit të arsytimit nga ana e Gjykatës së Lartë.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

E drejta e pronës private – Parimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes

FJALË KYÇE
Kontratë sipërmarrjeje/ pasuri e fshehur/ produkt i veprës penale/ masë sigurimi pasuror/ sekuestro preventive

Vendimi i sekuestros, ndonëse me karakter të përkohshëm, ndërhyr në të drejtat kushtetuese individuale, siç është ajo e pronës, ndërhyrje që vazhdon deri në dhënien e një vendimi të mundshëm për konfiskimin e pasurisë. Ai konsiderohet përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues ndaj Gjykata vlerëson nëse ky kufizim respekton kriteret kushtetuese të ndërhyrjes, pra nëse është bërë me ligj, për interes publik dhe nëse respekton kriterin e proporcionalitetit.

Elda Dinaj (kufizimi i së drejtës së pronës me vendime për vendosjen e sekuestros preventive) – vendimi nr. 29, datë 16.04.2024

Faktet

Kërkueses rezulton t'i kenë kaluar të drejta pronësie mbi pasuritë e paluajshme vilë dhe një sipërfaqe toke, për të cilat GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur caktimin e masës së sekuestros preventive, si pasuri të fshehura dhe objekt material i pastrimit të produkteve të veprës penale, në kuadër të një hetimi penal ndaj një funksionari publik. GJKKO-ja e Apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kanë lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e pronës - Masa e sekuestros është vendosur në bazë të nenit 274 të KPP-së, i cili lejon sekuestrimin kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj, rrjedhimisht ndërhyrja në të drejtën e pronës është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik. Masa e sekuestros preventive: (i) justifikon nevojën e ndërhyrjes, sepse synon të pengojë çdo transferim të mundshëm të pasurisë me qëllim që të sigurojë mbarëvajtjen e procedimit penal; (ii) është e përshtatshme, se mbetet një mjet me natyrë të përkohshme që balancon në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme qëllimin e procedimit penal me interesat e kërkueses; (iii) nuk është më e ashpër se sa objektivi që kërkohet të arrihet, sepse kufizimi i së drejtës së kërkueses për të gëzuar dhe poseduar pasurinë e saj vendoset përballë objektivit për parandalimin e kryerjes së mëtejshme të veprës penale. Midis vendimit të sekuestros dhe qëllimit të ndjekur duket se ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, prandaj kufizimi i së drejtës së kërkueses për të gëzuar dhe poseduar pasurinë e saj është në raport të drejtë me gjendjen që ka diktuar nxjerrjen e tij.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (një gjyqtar është shprehur me mendim kundër).

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj – Parimi i paanshmërisë në gjykim – Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Kontratë kredie/ shërbim arkivor/ fuqia detyruese e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese/ të dhëna personale/ short/ veprimtaria e këshilltarit ligjor/ dilijencë

Argumenti se gjyqtari relator e ka dërguar njoftimin në adresa të pavlefshme është i pamjaftueshëm për të provuar njëanshmërinë e tij, në kushtet kur aktet e njoftimit përpilohen dhe dërgohen nga sekretaria gjyqësore.

Periudha e shkurtër e rishqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk përbën argument që të provojë pretendimin për paanshmëri në kuptimin subjektiv.

Interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë nuk rezulton të jetë arbitrar dhe as me gabime ligjore evidente që të kenë prishur drejtësinë e procesit.

Odise Xhelita (interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë) – vendimi nr. 30, datë 18.04.2024

Faktet

Pas mbylljes së parakohshme të një kredie pranë një banke tregtare, kërkuesi ka zhvilluar një korrespondencë fillimisht me vetë bankën dhe në vijim me Bankën e Shqipërisë, duke kërkuar ndërhyrjen e kësaj të fundit me mjete korrigjuese për uljen e interesave dhe kostove të aplikuara si dhe uljen e shpenzimeve për sigurimin e jetës. Pas përgjigjes mbi veprimet korrigjuese, kërkuesi i është drejtuar Bankës së Shqipërisë duke kërkuar kopje të njehsuar të praktikës së procesit administrativ dhe dokumentacionin e inspektimit. Ajo i është përgjigjur se konkluzionet e procesit administrativ i janë vënë tashmë në dispozicion, ndërsa komunikimet mes saj dhe bankës tregtare janë konfidenciale. Kërkuesi ka paraqitur padi kundër Bankës së Shqipërisë, e cila është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

Gjykata Kushtetuese ka pranuar kërkesën e kërkuesit për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe ka dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë. Kjo e fundit ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj - Argumentet e kërkuesit janë hipotetike dhe nuk mjaftojnë për të mbështetur pretendimin e tij, pasi, ndonëse pohon se nuk disponon ndonjë të dhënë faktike, ai nxjerr përfundimin për shkeljen e rregullave të shortit për caktimin e gjyqtarëve. Për sa i përket veprimtarisë së këshilltarit ligjor ajo ka natyrë ndihmëse dhe këshillimore për funksionet gjyqësore të trupit gjykues dhe dokumentohet në akte me karakter të brendshëm, të cilat nuk janë të detyrueshme për t'iu komunikuar palëve.

Parimi i gjykatës së paanshme – Aktet e njoftimit të palëve përpilohen dhe dërgohen nga sekretaria gjyqësore, ndërsa gjyqtari ka detyrën të verifikojë dhe mbikëqyrë realizimin e tyre. Saktësia e veprimeve të administratës gjyqësore në kryerjen e njoftimeve paraqet rëndësi thelbësore në drejtim të efektivitetit të gjykimit, ndërsa lidhur me elementet e procesit të rregullt ligjor ajo merr vlerë përcaktuese kur nuk është riparuar nga gjyqtari përgjegjës dhe eventualisht i ka sjellë pasojë reale individit në ushtrimin e të drejtave kushtetuese. Periudha e shkurtër e rishqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk përbën argument që të provojë pretendimin për cenimin e paanshmërisë në kuptimin subjektiv. Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje pas rikthimit të çështjes nga Gjykata dhe bazuar në vendimin nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky fakt përbën shkak për shqyrtimin e çështjes me përparësi. Për sa i përket paanshmërisë objektive, kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë konkrete për të mbështetur këtë pretendim.

Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor – Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje të shprehur kërkuesit se pretendimi i parashtruar në shtesën e rekursit është i papranueshëm. Interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë nuk rezulton të jetë arbitrar dhe as me gabime ligjore evidente, që të kenë prishur drejtësinë e procesit. Gjykata e Lartë ka interpretuar ligjin brenda kompetencave kushtetuese të saj dhe ky interpretim nuk rezulton të jetë haptazi i paarsyeshëm. Gjykata e Lartë ka pasqyruar në vendim shkaqet e parashtruara në shtesën e rekursit, si dhe ka arsytuar përse kjo shtesë rekursi nuk mund të merrej në shqyrtim. Ajo e ka shqyrtuar rekursin në themelin e tij dhe ka arsytuar edhe për të drejtën për informim në raport me legjislacionin bankar.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

E drejta e pronës private - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Ndërtim pa leje/ shpërblim dëmi/ fitim i munguar/ gjë e gjykuar/ parashkrim i padisë

Në procesin e parë gjyqësor kërkuesi ka kërkuar edhe shpërblimin e dëmit në formën e fitimit të munguar, duke e pranuar atë në masën e caktuar nga gjykata, pavarësisht mënyrës dhe periudhës së përlllogaritjes së tij, vendim ky që përbën gjë të gjykuar.

Agim Goga (parashkrimi i padisë për kërkimin e fitimit të munguar) – vendimi nr. 31, datë 18.04.2024

Faktet

Kërkuesit i është prishur plotësisht një objekt në pronësi të tij, sipas një vendimi të Degës së Policisë Ndërtimore, i cili në vijim është shfuqizuar nga Drejtoria e Policisë Ndërtimore. Kërkuesi ka kundërshtuar gjyqësisht prishjen e objektit, duke kërkuar edhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar dhe fitimin e munguar. Përfundimisht gjykata e apelit ka njohur detyrimin e të paditurve për lirim dhe dorëzim të truallit të zënë, për të ndërtuar objektin në gjendjen e mëparshme dhe për t'i paguar kërkuesit dëmin dhe fitimin e munguar. Meqënëse detyrimi për të ndërtuar objektin në gjendjen e mëparshme nuk është përmbushur nga të paditurit, kërkuesi i është drejtuar sërish gjykatës duke kërkuar shpërblimin e dëmit dhe fitimin e munguar deri në ekzekutimin e plotë të vendimit (ndërtimin e objektit). Gjykatat e të tria shkallëve të gjykimit e kanë rrëzuar këtë pretendim si gjë të gjykuar.

Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor i lidhur me të drejtën e pronës private – Në procesin e parë gjyqësor kërkuesi ka kërkuar edhe shpërblimin e dëmit në formën e fitimit të munguar për periudhën nga dita e prishjes së objektit deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Ai nuk ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, përmes të cilit është vendosur detyrimi i të paditurve për të ndërtuar objektin në gjendjen e mëparshme, si dhe për t'i paguar kërkuesit fitimin e munguar, duke pranuar fitimin e munguar në masën e caktuar, pavarësisht mënyrës dhe periudhës së përlllogaritjes së tij. Për sa kohë që ky vendim nuk është kundërshtuar nga kërkuesi, ai përbën gjë të gjykuar. Pretendimet e kërkuesit, që në thelb kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, për sa ajo ka disponuar në lidhje me fitimin e munguar, duhej të ishin bërë objekt i mjetit të ankimit dhe më pas i vlerësimit nga një gjykatë më e lartë, por jo i një kërkimi të ri. Pretendimet e tjera për ndërtimin e objektit në gjendjen e mëparshme, lidhen me ekzekutimin e vendimit gjyqësor, për të cilin ligji procedural ka parashikuar mjetet dhe procedurën e ekzekutimit të tij.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

E drejta për t'u njoftuar
- E drejta për t'u dëgjuar
- E drejta për t'u mbrojtur

FJALË KYÇE

**Pafajësi/ gjendje të lirë/
kundërrekurs/ adresë
elektronike**

Mungesa e njoftimit të mbrojtësit të kërkuarit për seancën në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur ai nuk kishte pasur mundësi për të paraqitur pretendime në lidhje me rekursin e prokurorit, për shkak të parregullsive në njoftim dhe, për më tepër, kur objekt i rekursit është vendimi që e kishte deklaruar të pafajshëm kërkuarin, vë në dyshim respektimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në aspektin substancial të saj.

Rezart Myslymi (mungesa e njoftimit për shqyrtimin e rekursit në Gjykatën e Lartë) – vendimi nr. 32, datë 23.04.2024

Faktet

Kërkuari është dënuar me 5 vjet burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë e cila e ka deklaruar atë të pafajshëm. Mbi bazën e rekursit të prokurorit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual për cenimin e së drejtës për proces të rregullt.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta për t'u njoftuar e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur – Rekursi i është komunikuar babait të kërkuarit dhe sipas shënimit në dëftesën e komunikimit ai ka “refuzuar të firmosë”. Rekursi nuk i është njoftuar personalisht kërkuarit dhe as mbrojtësit të tij sipas formave të parashikuara nga dispozitat procedurale. Për sa i përket njoftimit për datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë avokati nuk rezulton të jetë njoftuar përmes postës elektronike. Krahas mangësive në njoftimin e rekursit, në kohën e paraqitjes së tij nga prokurori (viti 2017), dispozitat procedurale në fuqi nuk parashikonin të drejtën e kundërrekursit.

Mungesa e njoftimit të mbrojtësit të kërkuarit, në kushtet kur ai nuk kishte mundësi për të paraqitur më parë pretendime në lidhje me rekursin e prokurorit, për shkak të parregullsive në njoftim, dhe, për më tepër, kur objekt i rekursit është vendimi që e kishte deklaruar të pafajshëm kërkuarin, vë në dyshim respektimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në aspektin substancial. Kërkuari ka qenë në pamundësi të ushtrrojë të drejtën e mbrojtjes ndaj shkaqeve të rekursit dhe të parashtrrojë pretendimet e tij në lidhje me procesin gjyqësor të kundërshtuar, në kuptim edhe të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Për më tepër, mbi bazën e shkaqeve të rekursit të prokurorit, Kolegji Penal ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, i cili e kishte deklaruar kërkuarin të pafajshëm, pas një kohe prej më shumë se 5 vjetësh nga dhënia e atij vendimi.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (katër gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

**E drejta e aksesit –
Standardi i arsytimit
të vendimit gjyqësor -
E drejta e mbrojtjes
efektive**

FJALË KYÇE
**Kontratë shitje kuotash/
kontratë huaje/
juridiksion/ klauzolë
arbitrazhi/**

**Në gjykatat e zakonshme
është diskutuar, në thelb,
për çështjen e juridiksionit
dhe kontratave të lidhura
midis palëve, e ngritur si
pretendim nga subjekti i
interesuar.**

**Gjykata e Lartë nuk ka
vënë në diskutim çështje të
ligjit, për të cilat palët nuk
kanë qenë në dijeni ose nuk
kanë pasur mundësi të
debatonin.**

Shoqëria “Energy Albania Group” sh.p.k. dhe shoqëria “MP-HEC” sh.p.k. (juridiksion arbitrazhi) – vendimi nr. 33, datë 23.04.2024

Faktet

Kërkueset kanë nënshkruar një kontratë paraprake për shitjen e kuotave të njëres prej shoqërive të subjekti i interesuar, sipas të cilës, zgjidhja e çdo mosmarrëveshjeje do të bëhej nga arbitrazhi në Romë. Po sipas kësaj kontrate, subjekti i interesuar bëri një pagesë në favor të kërkueseve. Gjithashtu, ndërmjet njëres prej kërkueseve dhe subjektit të interesuar u nënshkrua një kontratë huaje, sipas të cilës mosmarrëveshjet ndërmjet palëve do të shqyrtoheshin nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Duke qenë se nga kërkueset u refuzua tërheqja e subjektit të interesuar nga kontrata paraprake dhe kthimi i shumë së paguar, ai iu drejtua arbitrazhit, që pranoi padinë, duke detyruar kërkueset për kthimin e shumës. Në vijim, subjekti i interesuar kërkoi përmbushjen e detyrimit, sipas vendimit të arbitrazhit. Kërkueset iu drejtuan Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shuarjen e detyrimit. Gjykata vendosi mungesën e juridiksionit gjyqësor me arsytimin se ai i përket arbitrazhit, vendim i cili u la në fuqi nga Gjykata e Lartë, me arsytimin se kontrata e huas referonte te kontrata paraprake që parashikonte zgjidhjen e mosmarrëveshjeve vetëm në arbitrazh. Kërkueset iu drejtuan Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor - Gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë kanë marrë në shqyrtim çështjen e juridiksionit lidhur me kontratën paraprake dhe kontratën e huas. Gjykata e Lartë ka çmuar se kontrata e huas me të cilën kërkueset pretendojnë se është ndryshuar klauzola e arbitrazhit, nuk është e vlefshme, pasi ajo është nënshkruar vetëm nga njëra prej kërkueseve dhe nuk është nënshkruar edhe nga shoqëria tjetër, sikurse kontrata paraprake. Gjykata e Lartë nuk ka vënë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë qenë në dijeni ose nuk kanë pasur mundësi të jepnin mendimin e tyre, përkundrazi, të dyja gjykatat kanë argumentuar se kontrata paraprake referon në juridiksionin e arbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve. Gjykatat, në ushtrim të kompetencës së tyre, kanë interpretuar përmbajtjen e kontratave dhe kanë arritur në përfundimin se ato janë të lidhura, duke arsyetuar se kontrata e huas nuk mund të interpretohet pa analizuar kushtet e kontratës paraprake të shitjes së kuotave.

E drejta e mbrojtjes efektive - Për sa i përket njoftimit të kërkueseve, edhe pse ato kishin lënë të dhënat elektronike të kontaktit (e-mail), nuk rezulton t’u jetë komunikuar njoftimi për datën dhe orën e zhvillimit të seancës. Megjithatë, mungesa e njoftimit individual nëpërmjet adresave elektronike të kontaktit, nuk rezulton t’i ketë vendosur kërkueset në pozita të pafavorshme ose të ketë ndikuar në mohimin e së drejtës së mbrojtjes, në kuptimin substancial, ndaj nuk është e mjaftueshme që ta bëjë procesin të parregullt, në kuptimin kushtetues.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (katër gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

E drejta për t`u gjykuar nga një gjykatë e paanshme – E drejta e aksesit në gjykim

FJALË KYÇE
Rekurs i shkurtuar/ zënie afati/ rekurs i plotë/ akte të paplota/ administratë gjyqësore

Si pasojë e veprimeve të mangëta të administratës gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë, në drejtim të administrimit dhe përcjelljes së akteve, rekursi i shkurtuar nuk është përfshirë në dosjen gjyqësore dhe as nuk i është nënshtruar vlerësimit të Gjykatës së Lartë, me pasojën e mospranimit për shqyrtim të rekursit të plotë.

Shoqëria “ILIAD 1” sh.p.k. (mosadministrimi në dosjen gjyqësore i rekursit të shkurtuar për zënie e afatit të ankimit) – vendimi nr. 35, datë 25.04.2024

Faktet

Kërkuesja ka marrë me qira në vitin 2002 një sipërfaqe trualli nga ish- MZHETTS (sot MEF), një pjesë e së cilës mbivendosej me truallin e kthyer në vitin 1995 subjekteve të interesuara me vendim të KKKP-së Vlorë. Mbi padinë e këtyre të fundit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka konstatuar absolutisht të pavlefshme kontratën e qirasë për atë pjesë që lidhej me pasurinë e tyre dhe kthimin e saj këtyre subjekteve, vendim i cili është lënë në fuqi në të gjitha shkallët e gjykimit. Kërkuesja, e detyruar të kthente një pjesë të truallit në zbatim të vendimeve të formës së prerë, ka kërkuar gjyqësisht detyrimin e subjekteve të interesuara t'i kthenin shpenzimet e nevojshme dhe të dobishme të kryera për truallin si dhe shpërblimin për humbjen e pësuar dhe fitimin e munguar. Subjektet e interesuara kanë paraqitur kundërpadi duke kërkuar shpërblim dëmi jashtëkontraktor nga përdorimi i pronës së tyre. Gjykata e shkallës së parë ka pranuar pjesërisht padinë, vendim që është lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit, duke rrëzuar kërkimin për fitimin e munguar, si dhe mospranimit e rekursit të kërkueses si i paraqitur jashtë afatit ligjor. Kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa aspekte të saj.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme -Edhe pse informacioni për përbërjen e trupit gjykues është shpallur në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, kërkuesja nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për zëvendësim të gjyqtarëve me pretendimin për paanshmëri. Gjyqtarët që kanë shqyrtuar çështjen në Gjykatën e Lartë kanë qenë më parë pjesë e trupit gjykues të po asaj gjykate që ka dhënë vendimin në përfundim të procesit gjyqësor të themelit, ku është vendosur mospranimit i rekursit të kërkueses. Gjykata e Lartë në atë rast ka shqyrtuar vetëm ekzistencën ose jo të shkaqeve ligjore në rekurs dhe jo themelin e mosmarrëveshjes midis palëve. Për rrjedhojë, nuk ka dyshime për njëanshmëri.

E drejta e aksesit - Kërkuesja ka depozituar aktin “rekurs i shkurtuar”, i cili është marrë në dorëzim nga administrata e gjykatës së shkallës së parë kundrejt nënshkrimit dhe vulës zyrtare, me qëllim zënie e afatit, për sa kohë që vendimi i rekursuar nuk ishte arsyetuar ende. Në dosjen gjyqësore është administruar vetëm rekursi i plotë, ndërsa rekursi i shkurtuar mungon. Trupi gjykues i Gjykatës së Lartë, kur ka shqyrtuar çështjen e kërkueses dhe ka konstatuar në dosjen gjyqësore vetëm rekursin e plotë, nuk ka pasur gabim faktik ose ligjor në vlerësimin se ai ishte paraqitur jashtë afatit ligjor dhe për këtë shkak duhej vendosur mospranimit i tij. Në bazë të akteve të paraqitura nga kërkuesja dhe informacionit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Gjykata arrin në përfundimin se administrata gjyqësore e gjykatës së shkallës së parë ka vepruar në mënyrë të parregullt, pasi nuk ka dokumentuar në regjistrin e veçantë paraqitjen e rekursit të shkurtuar nga kërkuesja, nuk ia ka njoftuar atë palëve të tjera ndërgjyqëse dhe as nuk e ka përfshirë në aktet e dosjes gjyqësore që i është përcjellë Gjykatës së Lartë. Këto mangësi nuk mund të rëndojnë mbi kërkuesen, sepse do të krijonin një barrë të tepruar ndaj saj.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimit e kërkesës.

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

FJALË KYÇE
**marrëdhënie huaje/
parashkrim i padisë/
shuarje e së drejtës së
padisë/ kthim për
rigjykim**

Gjykata e Lartë, si gjykatë e ligjit, ka në kompetencën e saj kontrollin e mënyrës së zbatimit të ligjit dhe interpretimin përfundimtar të tij, me kusht që ky interpretim të jetë realizuar fillimisht nga dy gjykatat më të ulëta.

Gjyste Nikolli (juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë kur çështja nuk është shqyrtuar në themel në gjykatën e apelit)- vendim nr. 36, datë 30.04.2024

Faktet

Shtetasi P.K., trashëgimlënësi ligjor i kërkueses, i kishte dhënë shtetasit K.B. letra me vlerë, të cilat duhet t'ia kthente brenda një viti. Detyrimi nuk u përmbush, për pasojë P.K. paraqiti padi kundër trashëgimtarëve të K.B., për kthim shume. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin e rrëzoi kërkesëpadinë, për shkak se ishte parashkruar. Gjykata e Apelit Tiranë e prishi vendimin dhe e ktheu për rigjykim për shkelje procedurale, që lidhen me komunikimin palëve të paditura të kërkesës së paditësit për pakësimin e objektit të padisë. Ky vendim u prish nga Gjykata e Lartë që la në fuqi të vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkuësja (si trashëgimtare e P.K.) iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj - Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së apelit në lidhje me parregullsitë procedurale të konstatuara prej saj në gjykatën e shkallës së parë. Çështja e shuarjes së të drejtës së padisë nuk është bërë objekt vlerësimi nga gjykata e apelit, për sa kohë që ajo nuk është ndalur në mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave të KC-së, duke mos dhënë asnjë vlerësimi në lidhje me të drejtën e ushtrimit të padisë nga ana e paditësit. Edhe pse interpretimi i ligjit në lidhje me të drejtën e ushtrimit të padisë dhe parashkrimin e saj përbën çështje me natyrë ligjore, Gjykata e Lartë nuk duhej t'i jepte fund procesit gjyqësor me vendim përfundimtar, në kushtet kur gjykata e apelit nuk ishte shprehur për parashkrimin e padisë.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).



VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm – Parimi i objektivitetit të gjykimit dhe paanshmërisë në gjykim - E drejta për t'u rehabilituar dhe/ose zhdëmtuar në përputhje me ligjin

FJALË KYÇE
Gjobë/ titull ekzekutiv/
abuzim me të drejtën për
ankim kushtetues
individual/ barrë e provës



Nga momenti kur ka depozituar kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë, deri kur ka depozituar ankimin kushtetues individual, kërkuesi nuk e gëzonte më statusin e gjyqtarit, si pasojë e shkarkimit të tij nga KPK-ja, lënë në fuqi nga KPA-ja. Në këtë këndvështrim kërkuesi nuk ka arritur të provojë cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave të tij nga kohëzgjatja e procesit të themelit.

Ervin Trashi - vendimi nr. 49, datë 19.03.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Faktet

Kërkuesi konkurroi për pozicionin vakant të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Vlorë. KLD-ja i propozoi Presidentit emërimin e kërkuetit si gjyqtar në gjykatën e apelit. Për shkak se Presidenti nuk u shpreh për propozimin, KLD-ja rishpalli pozicionin vakant. Kërkuesi iu drejtua gjykatës administrative për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ të Presidentit për rrëzimin në heshtje të kandidaturës. Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesëpadisë. Mbi ankimin e kërkuetit çështja u regjistrua në Gjykatën Administrative të Apelit. Në vijim, ai paraqiti kërkesë për përsheptimin e gjykimit të çështjes dhe gjykata planifikoi shqyrtimin për në datën 14.09.2023.

Në datën 03.07.2023 kërkuesi paraqiti në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykatën e apelit, për të cilën Kolegji Administrativ vendosi pushimin, pasi çështja ishte planifikuar për t'u gjykuar nga gjykata e apelit.

Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Legjitimimi ratione personae - Kërkuesi është shkarkuar nga detyra me vendim të KPK-së, i lënë në fuqi nga KPA-ja ndaj Gjykata Administrative e Apelit, në lidhje me gjykimin e themelit, vendosi pushimin e çështjes pasi ka mbetur pa lëndë shqyrtimi. Kurse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkuetit.

Nga data 03.07.2023, kur ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, deri në datën 20.12.2023, kur ka paraqitur ankim kushtetues individual, kërkuesi nuk gëzonte më statusin e gjyqtarit. Për rrjedhojë, ai nuk ka arritur të provojë cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave të tij, në drejtim të dëmit/pasojave të drejtpërdrejta dhe reale të ardhura nga kohëzgjatja e procesit të themelit, ndaj nuk legjitimohet *ratione personae* për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

Vendimmarrja

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, njëzëri, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare

VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

**Parimi i barazisë
përpara ligjit - Parimi i
mosdënimit pa ligj - E
drejta për t'u zgjedhur
- Parimi i
proporcionalitetit**

FJALË KYÇE

***E drejta për t'u zgjedhur/
kandidat për kryetar
bashkie/ zgjedhje
vendore/ arresti në burg/
leje e veçantë/ këshill
bashkiak/***



***Mbrojtja kushtetuese ka
funksion përfundimtar
dhe, si e tillë, mund të
aplikohet vetëm në lidhje
me vendime për të cilat
kanë përfunduar
procedurat gjyqësore.
Ankimi kushtetues
individual në këtë rast
nuk është mjete i vetëm që
garanton legjislacioni për
mbrojtjen e të drejtave
kushtetuese, për sa kohë
kërkuesi ka nisur një
proces gjyqësor pranë
gjykatave të juridiksionit
të zakonshëm.***

**Dhionisios Alfred Beleri - vendimi nr. 57, datë
03.04.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve**

Faktet

Kërkuesi është arrestuar në flagrancë dy ditë para zhvillimit të zgjedhjeve, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim dhe ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal “Arresti në burg”. KQZ-ja ka vendosur dhënien kërkuesit të mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë, ndaj ai ka paraqitur kërkesa për marrjen e lejes së veçantë për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak Himarë, të cilat janë refuzuar nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve. Kërkuesi është drejtuar GJKKO-së së shkallës së parë, që ka shpallur moskompetencën lëndore, duke e dërguar çështjen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Gjykata e Lartë ka zgjidhur mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore duke përcaktuar si gjykatë kompetente GJKKO-në e shkallës së parë. Pa përfunduar ende gjykimi i çështjes nga kjo e fundit, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, çështje që është kaluar nga Kolegji i Gjykatës për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive - Pretendimi i kërkuesit se vetëm nëpërmjet ankimit kushtetues individual mund të vihet në vend e drejta për t'u zgjedhur nuk është i bazuar, pasi në këtë rast ankimi kushtetues individual nuk është mjete i vetëm që i garanton legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, për sa kohë ai ka nisur një proces gjyqësor pranë gjykatave të zakonshme me të njëjtin objekt, kundërshtimin/shfuqizimin e shkresës administrative nr. 1938/2023, që lidhet me kufizimin e së drejtës për t'u zgjedhur. Duke qenë se pretendimet për kundërshtimin/shfuqizimin e aktit objekt kërkese kërkuesi ia ka nënshtruar juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, ato mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues pas përfundimit të procesit të nisur në ato gjykata.

Kërkuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës.

Vendimmarrja

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, njëzëri, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

Liria personale - Standardi i arsytimit të vendimit

FJALË KYÇE
**Kandidat për kryetar
bashkie/ zgjedhje
vendore/ përgjim
ambiental/ arrestim në
flagrancë/ vleftësim i
ligjshëm i arrestimit në
flagrancë**



**Vleftësimi i arrestit në
flagrancë dhe kufizimi i
lirisë personale të
kërkuesit nuk rezulton të
jetë bërë në kundërshtim
me nenet 27 dhe 28 të
Kushtetutës, dispozitat e
KEDNJ-në ose dispozitat
ligjore në fuqi. Po kështu
janë respektuar edhe
parashikimet
kushtetuese që
përcaktojnë afatin për
t`u dërguar përpara
gjyqtarit dhe për të pasur
një vleftësim të arrestit,
si dhe të drejtën e ankimit
dhe atë për të pasur një
shqyrtim gjyqësor.**

Dhionisios Alfred Beleri - vendimi nr. 72, datë 08.04.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Faktet

Kërkuesi ka qenë kandidat për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Përpara zhvillimit të zgjedhjeve organi i akuzës ka regjistruar procedimin penal ndaj tij duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”. Me autorizim të prokurorit kërkuesi është vënë në përgjim ambiental dhe më pas është arrestuar. Arrestimi është vleftësuar i ligjshëm nga gjykata e shkallës së parë, e cila më pas ia ka dërguar çështjen GJKKO-së së shkallës së parë, si gjykata kompetente. Vleftësimi i arrestit në flagrancë të kërkuesit është lënë në fuqi edhe nga gjykatat më të larta.

Ky proces është kundërshtuar nga kërkuesi në Gjykatë dhe Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e saj për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Liria personale e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor - Arrestimi në flagrancë është bërë duke respektuar procedurat e parashikuara nga KPP-ja dhe vleftësimi i masës është shqyrtuar nga gjykatat, të cilat kanë përcaktuar momentin dhe aktin mbi bazën e të cilit është bërë heqja e lirisë, duke dhënë edhe argumente në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve të organeve ligjzbatuese. Gjykatat e faktit kanë analizuar faktet dhe provat në ngarkim të kërkuesit, si dhe kanë analizuar dispozitat ligjore përkatëse të zbatueshme, në raport me kushtet dhe kriteret për gjendjen e flagrancës, duke arsytuar vendimet. Gjykata e Lartë, referuar pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë e ligjit, ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs duke verifikuar dhe vlerësuar se vendimet që kanë vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë dhe kufizimin e lirisë personale janë të drejta. Gjykatat e zakonshme kanë mbajtur parasysh garancitë e ofruara nga kuadri kushtetues dhe ligjor në këtë drejtim, duke garantuar edhe standardin e arsytimit.

Vendimmarrja

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, me shumicë votash, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

E drejta e pronës private – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

**Kontratë bashkëinvestimi/
investitor/ sipërmarrës/
masë sigurimi pasuror/
sekuestro preventive**



Në drejtim të legjitimitetit *ratione personae* individuali duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kërkesja nuk ka ngritur pretendime ndaj masës së sekuestros, por në thelb ka kundërshtuar disponimin për lënien e një pjese të sendit në përdorim të të tretëve, duke mos argumentuar, për rrjedhojë, pasojat e drejtpërdrejta dhe reale në të drejtën e saj të pronës.

Shoqëria “Star Construction” sh.p.k. - vendimi nr. 90, datë 30.04.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Faktet

Prokuroria ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të administratorit të një shoqërie, për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i KP-së, në bazë të kallëzimit penal të paraqitur nga kërkuësja. Mbi bazën e kërkesës së prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur sekuestron preventive për objektin strukturë për banim dhe shërbim për të cilin mes kërkuësës dhe shoqërisë tjetër kishte një kontratë bashkëinvestimi në ndërtim. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit për sa i përket masës së sekuestros preventive, duke shtuar se një pjesë e njësisë të banimit, objekt i kontratave të sipërmarrjes t’u lihen në përdorim porositesve. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësës. Kërkuësja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

Legjitimiteti ratione personae - Kërkuësja nuk ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual ndaj vendimit të sekuestros, për të cilin legjitimiteti i saj procedural dhe substancial nuk do të vihej në dyshim. Madje këtë vendim ajo nuk e ka ankimuar as në gjykatën e apelit. Kërkuësja ka zgjedhur të paraqesë rekurs dhe në vijim, edhe ankim kushtetues individual ndaj vendimit të gjykatës së apelit, në pjesën që ka disponuar lënien e një pjese të sendit në përdorim të të tretëve. Lidhur me këtë vendimmarrje kërkuësja nuk ka argumentuar se si kalimi i së drejtës së përdorimit të një pjese të sendit të sekuestruar (pra në administrim të organeve shtetërore) të të tretët sjell pasojat e drejtpërdrejta dhe reale në të drejtën e pronës. Kjo e fundit i është kufizuar kërkuësës nga vendimi i caktimit të sekuestros, për të cilin ajo nuk ka asnjë kundërshtim.

Vendimmarrja

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, me shumicë votash, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.